



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 13. 11.2018

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”, TË NDRYSHUAR”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 13 nëntor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. Relatore e projektligjit është znj.Milva Ekonomi, zv/Kryetare e Komisionit.

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit, për të dhënë shpjegime ishte e pranishme znj. Enkeleda Kuçi, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81, 83, pika1, dhe 155 të Kushtetutës. Ky projektligj propozohet në kuadër të Paketës Fiskale 2019 dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

Diskutimi në parim i projektligjit u realizua nga deputetët e shumicës, pasi opozita nuk mori pjesë.

II.QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Projektligji synon të realizojë :

- nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive;
- nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, duke zëvendësuar autobusët e transportit publik me naftë me autobusë elektrikë;
- mbështetjen e sektorit bujqësor, duke lehtësuar kostot e investimit;
- adresimin e kërkesës së industrisë fasone për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

2.2. Risitë e projektligjit

-Furnizimi (shitja) e shërbimit të reklamave nga media elektronike është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas shkronjës “j”, të nenit 53, të ligjit “Për TVSH-në”, dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji, këto subjekte nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimeve të përjashtuara, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbresin TVSH-në e paguar në blerje. TVSH-ja e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, në këtë rast, është kosto për mediat.

Me qëllim nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në kuadër të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet), propozohet që shkalla e reduktuar 6 për qind të aplikohet edhe për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet).

Parashikohet heqja nga lista e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja e furnizimit të shërbimit të reklamave nga media elektronike etj.

Gjithashtu, propozohet edhe aplikimi i një shkalle tjetër të reduktuar 10 për qind, për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me dhjetë vënde ose më shumë, vetëm me motor elektrik.

Parashikohet trajtimi i furnizimit të makinave bujqësore si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit, Komisioni nuk e quajti të arsyeshme të bëjë konsultim për këtë projektligj.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, miratoi në parim, me votat e gjithë deputetëve të mazhorancës, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

ZV/KRYETARE

DHE RELATORE

Milva EKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 19.11.2018

RAPORT

PËR SHQYRTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT “ PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”, TË NDRYSHUAR”¹

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 19 nëntor 2018, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. Relatore e projektligjit është znj.Milva Ekonomi, zv/Kryetare e Komisionit.

Gjatë diskutimit nen për nen për nen e në tërësi të projektligjit, për të dhënë shpjegime ishte e pranishme **z. Gentian Opre, drejtor i Buxhetit** në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës. Ky projektligj propozohet në kuadër të Paketës Fiskale 2019 dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

Diskutimi në parim i projektligjit u realizua nga deputetët e shumicës, pasi opozita nuk mori pjesë.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1 Qëllimi i projektligjit:

Projektligji synon të realizojë:

- nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive;

- nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, duke zëvendësuar autobusët e transportit publik me naftë me autobusë elektrikë;
- mbështetjen e sektorit bujqësor, duke lehtësuar kostot e investimit;
- adresimin e kërkesës së industrisë fasone për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

2.2 Risitë e projektligjit

- Furnizimi (shitja) e shërbimit të reklamave nga media elektronike është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas shkronjës “j”, të nenit 53, të ligjit “Për TVSH-në”, dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji, këto subjekte nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimeve të përjashtuara, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbresin TVSH-në e paguar në blerje. TVSH-ja e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, në këtë rast, është kosto për mediat.

Me qëllim nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në kuadër të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet), propozohet që shkalla e reduktuar 6 për qind të aplikohet edhe për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet).

Parashikohet heqja nga lista e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja e furnizimit të shërbimit të reklamave nga media elektronike etj..

Gjithashtu, propozohet edhe aplikimi i një shkalle tjetër të reduktuar 10 për qind, për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik.

Parashikohet trajtimi i furnizimit të makinave bujqësore si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Gjatë diskutimit nen për nen dhe në tërësi të projektligjit, Komisioni nuk e quajti të arsyeshme të bëjë konsultim për këtë projektligj, por mori në konsideratë letrën drejtuar këtij komisioni nga Shoqata e Botuesve të Shqipërisë.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, miratoi nen për nen e në tërësi, me votat e të gjithë deputetëve të mazhorancës, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Sugjeron që të shikohet mundësia që **në nenin 1, pika 6, pas fjalëve “media audiovizive”, të shtohen edhe fjalët “librave nga shtëpitë botuese”.**

ZV/KRYETARE

dhe RELATORE

Milva EKONOMI